
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA</b> <b>KOMUNA E SUHAREKËS</b> <b>OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA</b>	
---	--	---

<b>Nr:</b>	51/2024 - Nr: Protokolli: 85/2024
<b>Për:</b>	<b>BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË me adresë në Suharkë</b>
<b>Nga:</b>	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: <b>Fatos Kuqi</b>
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet</b>
<b>Datë:</b>	<b>28.08.2024</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **27.08.2024** nga Operatori Ekonomik: **BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË** me adresë në **Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i lapidarëve në Komunë, Vraniq, Dubravë, Krushic e Epërme** me Numër të prokurimit: **624-24-4418-521** Numër i brendshëm **624-24-41-521** nxjerr këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori **BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË** me adresë në **Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : **Ndërtimi i lapidarëve në Komunë, Vraniq, Dubravë, Krushic e Epërme** me Numër të prokurimit: **624-24-4418-521** Numër i brendshëm **624-24-41-521** kundër: (NJOFITIM VENDORIT TE AK), të datës **22.08.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

# ARSYETIM

**BAJRAM HA.GASHI B.I.**, Suharekë, 23000, SUHAREKË me adresë në **Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i lapidarëve në Komunë, Vraniq, Dubravë, Krushic e Epërme** me Numër të prokurimit: **624-24-4418-521** Numër i brendshëm: **624-24-41-521**  
Kundër (NJOFTIM VENDIMIT TË AK),, të datës: **22.08.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **27.08.2024** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

**Sa i perket pretendimit ankimor nr. 1 - nuk qëndron** ngase AK ka bere publikimin e Vendimit B58 po ashtu edhe figuron data si dhe nenshkrimi i ZP-se po ashtu edhe komunikimi me ZKF-ne perms postes elektronike i cili kerkon te behet anulimi i ketij aktiviteti ne munges te mejteve financiare.

Sipas ligjit te LPP-se kur mungesa e financimit per nje aktivitet mund te anulohet kur fondet e planifikuara nuk jane te disponueshme aktiviteti i prokurimit mund te anulohet.

**Sa i perket pretendimit ankimor nr. 2 - nuk qëndron** ngase Njoftimi per anulim nuk eshte bere sipas pretendimit tuaj "rekomandim per dhenie te kontrates OE te preferuar", por sic edhe e kemi cekur me larte se AK ne konsultime te vazhdueshme me ZKF, eshte konstatuar se nuk ka mjete financiare per te vazhduar me kete aktivitet dhe u vendos qe si i tille te anulohet.

**Sa i perket pretendimit ankimor nr. 3 - nuk qëndron** sepse AK-Zyra e Prokurimit-Komuna Suharekë ka respektuar afatet dhe ne konsistence te vazhdueshme me ZKF-ne eshte vertetuar se nuk ka mjete per vazhdim te ketij aktiviteti dhe na kane njoftuar se duhet te anulohet, per te mos hasur ne ndonje shkelje ligjore per mos respektim te afateve ligjore te pagesave te OE te mundshem fitues te ketij aktiviteti tenderues.

## KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

